



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

**GJIMNAZI
PËRGJITHSHËM**



Prishtinë, 23 qershor 2012

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'ju përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'ju zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?



1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'ju përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'ju përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

FIZIKË


1. Në cilin nga këto raste, njeriu ushtron shtypje më të madhe në bazë ?
- Kur është i ulur
 - Kur është i shtrirë
 - Duke qëndruar në dy këmbë
 - Duke qëndruar në një këmbë
2. Cila nga shprehjet e mëposhtme është e saktë për njësinë matëse të kapacitetit elektrik Farad (F) ?
- $F = \frac{C}{V}$
 - $F = C \cdot V$
 - $F = \frac{V}{C}$
 - $F = C \cdot s$
3. Temperatura në ngrohësin e një makine termike është (T_1), kurse në ftohës është (T_2). Në cilin rast rendimenti i makinës është maksimal ($\eta = 1$) ?
- $T_1 = T_2$
 - $T_2 = 0$
 - $T_1 = 0$
 - $T_1 > T_2$
4. Në figurë është paraqitur rasti kur rrezja e dritës bie në sipërfaqen kufitare që ndan vakumin me qelqin. Cila nga drejtëzat paraqet rrezet e reflektuar ?
- 1
 - 2
 - 3
 - 4
5. Si quhet procesi sipas të cilit gazi kalon në lëng ?
- Kondensim
 - Shkrirje
 - Avullim
 - Sublimin
6. Në diagram është dhënë varësia e elongacionit (zhvendosjes) të lëkundjes ndaj kohës. Sa është elongacioni i kësaj lëkundje për kohën $t=1s$?
- 3 cm
 - 7.5 cm
 - 0 cm
 - 2.5 cm



7. Një top futbollit lëvizë duke u rrotulluar nëpër një fushë të futbollit. Me cilën nga këto shprehje llogaritet energjia e përgjithshme kinetike e topit në lëvizje ?


- A. $E_k = \frac{mv^2}{2}$
 B. $E_k = \frac{I\omega^2}{2}$
 C. $E_k = \frac{mv^2}{2} + \frac{I\omega}{2}$
 D. $E_k = \frac{mv^2}{2} + \frac{I\omega^2}{2}$

8. Cila grimcë mungon në reaksionin e poshtëshënuar ?



- A. ${}_1H^1$
 B. ${}_1H^2$
 C. ${}_0n^1$
 D. ${}_1e^0$

9. Në figurë është paraqitur shufra e ngarkuar me elektricitet pozitiv dhe sfera elektroneutrale. Cili nga pohimet vijuese përshkruan saktë zhvendosjen e ngarkesave elektrike gjatë kontaktit të shufrës me sferën ?




- A. Ngarkesat negative nga sfera kalojnë tek shufra
 B. Ngarkesat negative nga shufra kalojnë tek sfera
 C. Ngarkesat pozitive nga sfera kalojnë tek shufra
 D. Ngarkesat pozitive nga shufra kalojnë tek sfera

10. Gjatësia valore e fotonit të parë me energji E_1 është λ_1 . Fotoni i dytë ka energji pesë herë më të madhe se i pari, $E_2 = 5 \cdot E_1$. Sa është gjatësia valore e fotonit të dytë ?

- A. $\lambda_2 = 5\lambda_1$
 B. $\lambda_2 = \lambda_1$
 C. $\lambda_2 = \frac{\lambda_1}{5}$
 D. $\lambda_2 = \frac{5}{\lambda_1}$

11. Në figurë është paraqitur makina për transportin e qumështit. Duke u bazuar në formën e nivelit të qumështit cili nga versionet e paraqitura në figurë paraqet gjendjen e lëvizjes së përshpejtuar të makinës ?

- A. 1
 B. 2
 C. 3
 D. 4




12. Çfarë ndodhë, kur elektroni në një atom kalon nga niveli më i lartë energjetik E_2 në atë më të ulët E_1 ?

- A. Emitohet fotoni me energji E_1-E_2
- B. Absorbohet fotoni me energji E_1-E_2
- C. Absorbohet fotoni me energji E_2-E_1
- D. Emitohet fotoni me energji E_2-E_1


13. Trupi zhvendoset përgjatë boshtit x , ku varësia kohore e pozitës është sikurse në figurë. Sa është zhvendosja x pas kohës $t=10$ s ?

- A. 0 m
- B. 6 m
- C. 10 m
- D. 20 m




14. Në figurë është paraqitur një elektromagnet i thjeshtë i ndërtuar nga një gozhdë e cila është e mbështjellur me një përcues të izoluar, skajet e së cilit janë të lidhura për bateri. Në cilën nga pozitat e shënuara ndodhet poli i jugut i fushës magnetike ?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4




15. Në sferën qiellore janë shënuar pika dhe vijat të ndryshme (shih fig.). Cila vijë paraqet meridianin dhe cila pikë paraqet polin e veriut ?

- A. Vija f dhe pika C
- B. Vija b dhe pika E
- C. Vija f dhe pika A
- D. Vija b dhe pika D



16. Në figurë është paraqitur varësia e shtypjes hidrostатike p e katër lëngjeve të ndryshme në funksion të thellësisë h . Cili nga këto lëngje e ka densitetin më të vogël ?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4



KIMI

17. Me cilën metodë mund të ndahet përzierja e lëngjeve që kanë pika të ndryshme të vlimit ?

- A. Me ndarje me magnet
- B. Me distilim fraksional
- C. Me filtrim
- D. Me sublimim

18. Sa është pH e një tretësire acidike ?

- A. pH=3
- B. pH=7
- C. pH=11
- D. pH=14

19. Cilat grimca subatomike gjenden në bërthamën e atomit ?

- A. Vetëm elektronet
- B. Vetëm neutronet
- C. Protonet dhe neutronet
- D. Protonet dhe elektronet


20. Si quhet reaksioni i bashkëveprimit të acideve karboksilike me alkoole ?

- A. Elektrolizë
- B. Hidrolizë
- C. Polimerizim
- D. Esterifikim

21. Cili nga komponimet vijuese, kur reagon me ujë liron hidrogjenin e gaztë ?

- A. LiH
- B. CH₄
- C. NH₃
- D. H₂S

22. Në këtë reaksion kimik, njëri nga produktet e fituara është:



- A. etil benzeni
- B. klor benzeni
- C. metil fenil ketoni
- D. metil benzeni

23. Cilat nga çiftet vijuese janë izomerë në mes vete ?

- A. $\text{CH}_3-\text{C}(\text{H})=\text{CH}_2$ dhe $\text{H}_2\text{C}=\text{C}(\text{H})-\text{CH}_3$
- B. $\text{H}_3\text{C}-\text{CH}_2-\text{C}(\text{H})(\text{CH}_3)-\text{CH}_3$ dhe $\text{H}_3\text{C}-\text{C}(\text{H})(\text{CH}_3)-\text{CH}_2-\text{CH}_3$
- C. $\text{H}_3\text{C}-\text{CH}_2-\text{CHO}$ dhe $\text{H}_3\text{C}-\text{CH}_2-\text{CH}_2-\text{OH}$
- D. $\text{H}_3\text{C}-\text{CH}_2-\text{O}-\text{CH}_3$ dhe $\text{H}_3\text{C}-\text{CH}_2-\text{CH}_2-\text{OH}$

24. Çfarë mjedisi tregon tretësira ujore e karbonatit të natriumit (Na_2CO_3) ?

- A. Bazik
- B. Acidik
- C. Neutral
- D. Amfotern





25. Cili është dallimi në mes të jonit të natriumit (Na^+) dhe atomit të natriumit (Na) ?

- A. Joni i natriumit (Na^+) ka një proton më pak sesa atomi i natriumit (Na)
- B. Joni i natriumit (Na^+) ka një elektron më pak sesa atomi i natriumit (Na)
- C. Joni i natriumit (Na^+) ka një proton më shumë sesa atomi i natriumit (Na)
- D. Joni i natriumit (Na^+) ka një elektron më shumë sesa atomi i natriumit (Na)

26. Cili reaksion ndodh gjatë elektrolizës së klorurit të magnezit MgCl_2 të shkrirë ?

- A. $\text{Mg}^{+2} \rightarrow \text{Mg} + 2\text{e}^-$
- B. $\text{Mg} \rightarrow \text{Mg}^{+2} + 2\text{e}^-$
- C. $\text{Mg}^{+2} + 2\text{e}^- \rightarrow \text{Mg}$
- D. $\text{Mg} + 2\text{e}^- \rightarrow \text{Mg}^{+2}$

27. Cili komponim përfitohet me oksidimin e propanolit-1 ?



28. Cilat sheqerna bëjnë pjesë në grupin e monosakarideve ?

- A. Laktoza dhe riboza
- B. Maltoza dhe amidoni
- C. Fruktoza dhe glukoza
- D. Saharoza dhe celuloza

29. Në një epruvetë janë përzier kristalet e klorurit të natriumit (NaCl) dhe të klorurit të amonit (NH₄Cl), nëse epruveta nxehtet në flakëdhënës do të vërejmë se:

- A. të dy kripërat shkrihen
- B. të dy kripërat sublimojnë
- C. NH₄Cl mbetet në pjesën e nxehtë ndërsa NaCl sublimon në pjesën e ftohtë të epruvetës
- D. NaCl mbetet në pjesën e nxehtë ndërsa NH₄Cl sublimon në pjesën e ftohtë të epruvetës


30. Një kimist i teston analizon dy substanca kristalore me ngjyrë të bardhë, A dhe B. Rezultatet e analizës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

| Lloji i analizës | Substanca A | Substanca B |
|--|----------------|-----------------------------|
| Pika e shkrirjes | 801°C | E ulët, zbërthehet në 186°C |
| Tretshmëria (g) për 100g H ₂ O | 35.7 g | 3.2 g |
| Përçueshmëria elektrike (në tretësira ujore) | Përçues i mirë | Jopërçues |


Nga rezultatet e këtyre testeve përfundojmë se:

- A. të dy substancat A dhe B kanë lidhje jonike
- B. të dy substancat A dhe B kanë lidhje kovalente
- C. substanca A ka vetëm lidhje jonike ndërsa substanca B vetëm lidhje kovalente
- D. substanca A ka vetëm lidhje kovalente ndërsa substanca B vetëm lidhje jonike


31. Cili nga hidrokarburet vijuese ka pikën e vlimit më të lartë ?




B.



C.




D.




32. Mangani në manganat kaliumi (K_2MnO_4) paraqitet me numër oksidues:

- A. +3
- B. +6
- C. +5
- D. +7


33. Cilat diagrame të mëposhtme paraqesin substanca të pastëra ?



I



II



III

- A. Vetëm I
- B. I dhe II
- C. I dhe III
- D. Vetëm II

BIOLOGJI

- 34.** Cili nga këto gjene është heterozigot ?
- A. AaBb
 - B. aabb
 - C. AABB
 - D. AACC
- 35.** Sa palë çifte nervore dalin prej trurit të shpendëve ?
- A. 10 palë
 - B. 12 palë
 - C. 20 palë
 - D. 24 palë
- 36.** Cila nga këto bimë përmban më së shumti fitoncide ?
- A. Molla
 - B. Dardha
 - C. Kumbulla
 - D. Eukaliptusi
- 37.** Cili organ i tretjes te njeriu e pengon kalimin e ushqimit në rrugët e frymëmarrjes ?
- A. Faringu
 - B. Laringu
 - C. Epiglotisi
 - D. Duodenumi
- 38.** Në cilën pjesë të qelizës kryhet oksidimi i materieve organike përmes ciklit të Krebsit ?
- A. Mitokondrie
 - B. Ribozome
 - C. Citoplazmë
 - D. Kloroplaste
- 39.** Nëse te prindërit gjenotipi për përcaktimin e grupeve të gjakut është BB x A0, çfarë do të jetë gjenotipi te pasardhësit ?
- A. AO, AB
 - B. AB, OO
 - C. AB, BO
 - D. OA, OB
- 40.** Çka ndodh në organizmin e njeriut nëse nuk funksionojnë veshkat ?
- A. Ndërprerja e filtrimit të gjakut
 - B. Ndërprerja e qarkullimit të gjakut
 - C. Ndërprerja e prodhimit të insulinës
 - D. Ndërprerja e prodhimit të tiroksinës

- 41.** Cilat organele qelizore e kryejnë zbërthimin e materieve organike në qelizë ?
- A. Aparati i Golxhit
 - B. Kloroplastet
 - C. Lizozomet
 - D. Centrozomet
- 42.** Cila prej bimëve të mëposhtme është indikator biologjik që përcakton shkallën e ndotjes së mjedisit ?
- A. Pisha
 - B. Myshqet
 - C. Gështenja
 - D. Fieri
- 43.** Cila metodë aplikohet për pastrimin e mjedisit të ndotur nga bakteriet duke i përdorur acidet ?
- A. Sterilizimi
 - B. Deratizimi
 - C. Pasterizimi
 - D. Dezinfektimi
- 44.** Cila është faza e parë e ciklit të zhvillimit të bakteriofagut ?
- A. Ngjitja e virusit për sipërfaqen e qelizës bakteriale
 - B. Depërtimi i acidit nukleik të virusit në qelizën bakteriale
 - C. Formimi i kapsidave dhe acideve nukleike të viruseve
 - D. Kompletimi dhe lirimi i bakteriofagëve të rinj
- 45.** Gjatë procesit të frymëmarrjes oksigjeni (O_2) kalon direkt nga ajri në gjak përmes:
- A. trakeve
 - B. faringut
 - C. laringut
 - D. alveoleve
- 46.** Cilat etapa të njëpasnjëshme kryhen në interfazë gjatë një cikli të ndarjes qelizore ?
- A. G_1 -S- G_2
 - B. G_1 - G_2 -S
 - C. S- G_2 - G_1
 - D. G_1 - G_2 -S
- 47.** Qarkullimi i madh i gjakut te njeriu:
- A. fillon nga barkushja e djathtë dhe përfundon në veshëzën e djathtë
 - B. fillon nga veshëza e djathtë dhe përfundon në barkushen e majtë
 - C. fillon nga barkushja e majtë dhe përfundon në veshëzën e djathtë
 - D. fillon nga veshëza e majtë dhe përfundon në barkushen e djathtë

48. Sa aminoacide gjatë sintezës së proteinave kodohen nga vargu i mëposhtëm i ARN(i) ?
CGUUUACACCGUCAC

- A. Tri aminoacide
- B. Pesë aminoacide
- C. Gjashtë aminoacide
- D. Tetë aminoacide

49. Në cilën pjesë të lëkurës gjenden receptorët për dhembje ?

- A. Dermë
- B. Epidermë
- C. Ind dhjamor
- D. Ind nënlëkuror

50. Si quhet vendi ku bashkohet qeliza nervore me qelizën e muskulit skeletik ?

- A. Akson
- B. Neurit
- C. Sinapsë
- D. Dentrit

HISTORI


- 51.** Me Zbulimet e mëdha gjeografike qendra e tregtisë evropiane u zhvendos nga Deti Mesdhe në Oqeanin Atlantik. Cilat vende evropiane përfituan ekonomikisht nga kjo zhvendosje rrugëve tregtare?
- A. Gjermania, Belgjika, dhe Greqia
 - B. Turqia, Austria dhe Hungaria
 - C. Spanja, Portugalia dhe Holanda
 - D. Polonia, Çekia dhe Bullgaria
- 52.** Cili është ndikimi kryesor që Reformacioni ushtroj në shoqërinë evropiane të kohës/?
- A. Forcimi i autoritetit të kishës mbi autoritetin e shtetit
 - B. Forcimi i autoritetit të shtetit mbi autoritetin e kishës
 - C. Dobësimi i autoritetit shtetit mbi klasën sunduese
 - D. Dobësimi i autoritetit të kishës mbi klasën skllavpronare
- 53.** Cilat ngjarje historike janë radhitur drejt sipas rendit kronologjik?
- A. Lufta e Parë Botërore, Luftërat Ballkanike
 - B. Beteja e Beratit, Rrethimi i parë i Krujës,
 - C. Lufta e Dytë Botërore, Atentati i Sarajevës
 - D. Beteja e Kosovës, Pushtimi i Konstantinopolit nga osmanët
- 54.** Interesat e cilës shoqëri i mbronin ligjet e mbretit Hamurab të Mesopotamisë ?
- A. Shoqërisë skllavpronare
 - B. Shoqërisë feudale
 - C. Shoqërisë kapitaliste
 - D. Shoqërisës socialiste
- 55.** Aushvici, Mathauzeni, Dahau dhe Buhenvaldi ishin:
- A. Qytete gjermane të bombarduar gjatë Luftës së II Botërore
 - B. Fushëbeteja të ashpra në mes gjermanëve dhe ruseve
 - C. Kampe të përqendrimit të ngritura nga nazistët
 - D. Vende ku korri fitore ushtria gjermane
- 56.** Janë dhënë pohimet:
- I. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë por në përgjithësi kërkesat e shqiptarëve nuk u përfillën.
- II. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë dhe kërkesat e shqiptarëve u përfillën nga evropianët
- III. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë por kërkesat e shqiptarëve u përfillën vetëm nga italianët
- Cili nga pohimet e dhëna është i saktë:
- A. Vetëm I
 - B. Vetëm II
 - C. Vetëm III
 - D. I, II dhe III

- 57.** Përveç në Kosovë në cilat njësi të Federatës Jugosllave u ndanë shqiptarët pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore?
- A. Bosne, Slloveni dhe Kroaci
 - B. Hercegovinë, Vojvodinë dhe Slloveni
 - C. Maqedoni Serbi dhe Mal të Zi
 - D. Kroaci, Vojvodinë dhe Bosne
- 58.** Në Kongesin e Manastirit (1908) përveç çështjes së alfabetit cilat ishin vendimet kombëtare që u diskutuan dhe u kërkuan nga osmanët ?
- A. Njohja e bashkimit kombëtar dhe e drejta e lëvizjes së lirë
 - B. Zhvillimi i forcave të armatosura dhe njësisive policore
 - C. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe arsimore
 - D. Njohja zyrtare e kombit shqiptar dhe e gjuhës shqipe
- 59.** Atentati i Sarajevës shërbeu si shkas për shpërthimin e :
- A. Luftës së Dytë Botërore
 - B. Luftës së Parë Botërore
 - C. Luftrave Ballkanike
 - D. Luftrave ruso-turke
- 60.** Përveç Gjermanisë cilat shtete gjatë Luftës së parë Botërore bënë pjesë në Aleancën Tripalëshe?
- A. Austro-Hungaria ,Perandoria Osmane dhe Bullgaria
 - B. Franca,Rusia dhe Perandoria Osmane
 - C. Anglia,Holanda dhe Belgjika
 - D. Italia,Franca dhe Anglia

GJEOGRAFI

61. Cila nga format relievore paraqet shkallëzimin tektonik:

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV



62. Shkenca e cila merret me studimin e mineraleve quhet:

- A. Klimatologji
- B. Petrologji
- C. Pedologji
- D. Gjeomorfologji

63. Atmosfera është mbështjelli i gazet i tokës, sa është pjesëmarrja e Azotit në të:

- A. 58 %
- B. 68 %
- C. 78 %
- D. 88 %

64. Si quhen vijat në hartat meteorologjike që bashkojnë vendet me temperatura të njëjta;

- A. Izoterme
- B. Izonefe
- C. Izohjete
- D. Izobare

65. Cili kontinent ka sipërfaqen ma të madhe:

- A. Evropa
- B. Azia
- C. Afrika
- D. Amerika veriore

66. Cila alternativë është e saktë:

- A. Kina, Pekini, Danubi, Muri Kinez
- B. Egjipti, Tripoli, Nili, Piramida
- C. Shqipëri, Tirana, Vardari, Dajti
- D. Britani e madhe, Londër, Temza, Big Beng

67. Gjiri i Meksikës gjendet në mesë:

- A. Amerikës Veriore – Azisë
- B. Amerikës Veriore – Amerikës Jugore
- C. Amerikës Jugore – Afrikës
- D. Amerikës Jugore – Australisë

68. Struktura biologjike e popullsisë përbëhet nga:

- A. Mosha, gjinia dhe profesioni
- B. Gjinia, profesioni dhe kualifikimi
- C. Mosha, gjinia dhe pjelloria
- D. Gjinia, profesioni dhe pjelloria

- 69.** Sipas llojit të produktit ose shërbimit që e bëjnë, veprimtarit ekonomike ndahen në tre sektor (primar, sekondar dhe terciar), cili kombinim i takon veprimtarisë primare:
- A. Bujqësia, pylltaria, Industria
 - B. Bujqësia, pylltaria, gjuetia
 - C. Pylltaria, gjuetia, Industria
 - D. Pylltaria, Industria, arsimi
- 70.** Prodhuesi më i madh i naftës në botë është:
- A. ShBA
 - B. Indonezia
 - C. Arabia Saudite
 - D. Norvegjia

SOCIOLOGJI

71. Sipas cilit mendimtarë, sociologjia do të studionte *dinamikën* dhe *statikën sociale* ?
- A. O. Konti
 - B. E. Dyrkemi
 - C. Zh. Ruso
 - D. S. Simoni
72. Përkufizimi: “ *Sociologjia është studim i jetës së grupeve shoqërore* ” është:
- A. i plotë dhe i kompletuar
 - B. i veçantë dhe i plotë
 - C. i përgjithshëm dhe i shumanshëm
 - D. i pranueshëm dhe i njëanshëm
73. Sipas *Platonit* shtetin duhet ta udhëheqin :
- A. nëpunësit
 - B. filozofët
 - C. rojtarët
 - D. robërit
74. Cili funksion i familjes karakterizohet me qetësi shpirtërore dhe mbështetje reciproke ?
- A. Faktori i shoqërorizimit
 - B. Riprodhimi i gjinisë njerëzore
 - C. Mbështetja emocionale
 - D. Ekonomia e përbashkët
75. Kombi është:
- A. bashkësi e madhe popujsh
 - B. bashkësi e vogël fisesh
 - C. bashkësi klasash
 - D. bashkësi me bazë etnike
76. Fe e përsosjes morale është:
- A. katolicizmi
 - B. islamizmi
 - C. budizmi
 - D. judaizmi
77. Burokracia paraqet :
- A. shtresën e veçantë sociale
 - B. elitën intelektuale në një shoqëri
 - C. elitën artistike në një shoqëri
 - D. kastën e privilegjuar në një shoqëri

- 78.** Dinamikën dhe fizikën sociale sociale i studioi:
- A. Kanti
 - B. Konti
 - C. Kanino
 - D. Kalvino
- 79.** Shoqëria paraindustriale karakterizohet me punë:
- A. industriale
 - B. teknologjike
 - C. bujqësore
 - D. kualifikuese
- 80.** Pushteti politik është shprehje e vullnetit të zotit, këtë teori e përfaqëson:
- A. Shën Augustini
 - B. Tomas Kompanella
 - C. Herber Spenseri
 - D. Tomë Akuni